



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MISTRAVE**

VENDIM

Nr. 449, datë 22.7.2021

“PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES DHE TË KATEGORIVE, QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, “TREGIME TË MOÇME SHQIPTARE’ DHE REVISTA LETRARE ‘LETRA NGA DIASPORA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”; të ndryshuar të shkronjës “gj”, të nenit 21, të ligjit nr.9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”; të ndryshuar dhe në vijim të pikave 10, shkronja “dh”, e 19, të vendimit nr.469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes, të teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, botimi dygjuhësh “Tregime të moçme shqiptare” dhe revista letrare “Letra nga Diaspora” sipas listës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit dhe të mësimin të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.
2. Kategoritë që i përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 443, datë 26.6.2019, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.
3. Botimi dygjuhësh “Tregime të moçme shqiptare” dhe revista letrare “Letra nga Diaspora”, të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jetë të pajisura me logon e këtij institucioni.
4. Çmimi i teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën “Tregime të moçme shqiptare” dhe “Letra nga Diaspora” vendoset në kopertinat përkatëse, në përputhje me listën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.



5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, ku përfshihen botimi, ambalazhimi dhe shpërndarja, përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën, për vitin 2021.
6. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I SHTETIT

PËR DIASPORËN

PANDELI MAJKO



Lista nr. 1

I. Çmimi në kopertinë prej 1000 lekësh, sipas tirazhit përkatës, për botimin dygjuhësh të “Tregime të moçme shqiptare”, me autor Mitrush Kutelin, në 5 gjuhë:

- | | |
|---|------------|
| 1. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip-anglisht) | 1000 copë |
| 2. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip-italisht) | 1000 copë |
| 3. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip-greqisht) | 1000 copë |
| 4. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip-gjermanisht) | 1000 copë |
| 5. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip-frëngjisht) | 1000 copë. |

II. Çmimin në kopertinë prej 1200 lekësh, sipas tirazhit përkatës, për revistën letrare “Letra nga Diaspora” në dy gjuhë:

- | | |
|------------------------------------|-----------|
| 1. “Letra nga Diaspora” (shqip) | 300 copë |
| 2. “Letra nga Diaspora” (anglisht) | 300 copë. |